Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY

ARRU



NIVELI I SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA OFRUESIT E LICENCUAR

2025

Nëntor, 2026

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT DHE AKRONIMET 3

HYRJE 4

1. PËRMBLEDHJE 5

1.1 ORGANIZIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT 5

1.2 NIVELI I SHËRBIMEVE TË UJIT 6

2. ORGANIZIMI, LICENCIMI DHE MONITORIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE 7

2.1 ORGANIZIMI DHE LICENCIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE 7

2.2 MONITORIMI I OFRUESVE TË LICENCUAR 8

3. NIVELI I SHËRBIMEVE I SIGURUAR NGA OFRUESIT E LICENCUAR TË SHËRBIMEVE TË UJIT 9

3.1 QASJA E POPULLATËS NË SHËRBIMET E UJËSJELLËSIT 9

3.2 FURNIZIMI I KONSUMATORËVE ME UJË 11

3.3 CILËSIA E UJIT TË FURNIZUAR 14

3.4 GRUMBULLIMI DHE TRAJTIMI I UJËRAVE TË NDOTURA 15

3.5 FATURIMI PËR SHËRBIMET E OFRUARA 17

3.6 RELACIONI "KRU-KONSUMATORË" 18

4. QËNDRUESHMËRIA E SHËRBIMEVE 21

5. BESUESHMËRIA E TË DHËNAVE 25

SHTOJCA 1: HARTAT E MBULUESHMËRISË ME SHËRBIME 27

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

ARRU	Autoriteti rregullator për Shërbimet e Ujit
ARPL	Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore
BE	Bashkimi Evropian
BOD_5	Nevoja Biokimike për Oksigjen
COD	Nevoja Kimike për Oksigjen
GIS	Sistemi i Informacioneve Gjeografike
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimt Hapsinor dhe Infrastrukturës
NH	Ndërmarrja Hidroekonomike

HYRJE

Raporti "Niveli i shërbimeve të ofruara nga ofruesit e licencuar" është raport i shtatë i publikuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, i cili ofron informacione në lidhje me nivelin e shërbimeve të ujit për vitin 2025 si dhe trendet zhvillimore krahasuar me vitin 2024. Raporti është përpiluar bazuar në gjetjet e inspektimeve të përgjithshme vjetore të zhvilluara tek shtatë KRU-të me qëllim të vlerësimit të zbatimit të obligimeve dhe vlerësimit të nivelit të standardeve të shërbimit nga ofruesit e shërbimeve.

Qëllimi i publikimit të këtij Raporti është sigurimi i informacioneve të hollësishme vendim-marrësve të sektorit të shërbimeve të ujit si dhe publikut të interesuar për nivelin e shërbimeve që janë ofruar konsumtorëve. Fushat kryesore analitike mbesin: siguria, cilësia dhe qëndrueshmëria e shërbimeve. Analiza e paraqitur në këtë raport është bazuar në të dhënat e raportuara nga ofruesit e licencuar, e të cilat janë verifikuar përmes inspektimeve nga ARRU si dhe nga procesimi i të dhënave detale për secilën KRU veç e veç në modulet përkatëse dhe për sektorin. Gjatë analizimit, përveç të dhënave të poseduara nga ofruesit e licencuar, janë marrë për bazë edhe informacionet e pranuara nga konsumatorët përmes hulumtimeve të kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimet e ujit. Për ARRU opinion dhe reagimi i konsumatorëve mbetet gjithmonë një nga matësit kryesor të nivelit të shërbimeve të ofruara nga ofruesit e licencuar të shërbimeve.

Përmes promovimit dhe mbështetjes së vazhdueshme për përmirësim të nivelit të shërbimeve ndaj konsumatorëve Autoriteti në vazhdimësi i monitoron dhe inkurajon ofruesit e licencuar në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve deri në arritjen dhe mirëmbajtjen e standardeve të përcaktuara dhe zbatimin e plotë të legjislacionit aktual.

Detajet në lidhje me nivelin e përmbushjes së standardeve të shërbimit dhe njëkohësisht përmbushjen e kushteve të licencës nga shtatë Ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit mund të i gjeni në kapitujt në vijim.

1. PËRMBLEDHJE

1.1 ORGANIZIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË UJIT

Shërbimet e furnizimit me ujë të pijës, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Kosovë sigurohen nga ofruesit publik rajonal (Kompanitë Rajonale të Ujit) ndërmarrje komunale dhe entitete. Nga këta ofrues vetëm shtatë janë të licencuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit.

Shtatë ofrues të licencuar të shërbimeve furnizojnë pjesën më të madhe të popullatës së Kosovës me ujë, që mbulojnë rreth 83% të popullatës, ndërsa në vitin 2024 mbulueshmëria ishte 82%. Mbulueshmëria me shërbimet e grumbullimit të ujërave të ndotura në vitin 2025 është 69.9%, kundrejt 69.6% sa ishte në vitin 2024.

Të shtatë ofruesit e licencuar në total vlerësohet se menaxhojnë afërsisht 9,425 km rrjet të ujësjellësit dhe rreth 3,301 km rrjet të kanalizimit.

Në vitin 2025 trajtimi i ujërave të ndotura, krahasuar me volumin e ujërave të ndotura të faturuara, arrinë në 22% pra vazhdon të mbetet i njëjtë sikurse në vitin 2024. Vlen të theksohet se ky standard i shërbimit edhe pse akoma në përqindje të ulët, në vitet në vijim pritet të ketë rritje të vazhdueshme si rezultat i ndërtimit të impianteve të reja të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN) nëpër qendrat tjera urbane.

Gjatë vitit 2025, ish ndërmarrjet komunale të Mitrovicës së Veriut, Zveqanit, Leposavicit dhe Zubin Potokut, janë marrë në menaxhim nga KRU Mitrovica, e cila është licencuar nga ARRU për të ofruar shërbimet e ujit edhe në këto katër (4) komuna. Duke qenë se procedurat rekrutimit të personelit në këto komuna, regjistrimit dhe futjes së konsumatorëve të këtyre komunave në sistemin e faturimit, , banorët e këtyre komunave nuk është përfshirë në mbulueshmerinë e shërbimeve.

Duhet të potencohet se të dhënat e paraqitura në këtë raport pasqyrojnë nivelin e shërbimeve të cilat ofrohen nga shtatë ofruesit e licencuar të shërbimeve, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë ligjore. Në disa zona rurale, popullata furnizohet me ujë nga entitete tjera, në formë të organizimeve vullnetare të komunitetit apo nga puset e tyre private. Këto sisteme operohen pa licencë për ofrimin e shërbimeve, pa leje ujore për shfrytëzimi e burimeve të ujit dhe nuk ka monitorim të mirëfilltë të kualitetit të ujit të furnizuar.

Mos integrimi i këtyre sistemeve rurale të ujësjellësit, të cilat janë jashtë menaxhimit nga KRU-të dhe funksionimi ilegal i disa prej tyre (duke ditur që uji i shfrytëzuar kryesisht nuk trajtohet si duhet) mund të rezultojnë me pasoja në shëndetin e asaj popullate. Problem tjetër për të këto sisteme mbetet degradimi fizik i aseteve të tyre në mungesë të një mirëmbajtje të rregullt. Poashtu, një numër i konsiderueshëm i sistemeve publike të grumbullimit të ujërave të ndotura (kanalizimit) vazhdojnë të mbeten jashtë menaxhimit nga KRU-të, kryesisht për arsye të moskoordinimit me komunat apo refuzimit të komunitetit për t'u integruar dhe menaxhuar nga KRU-të.

Bazuar në politikat dhe strategjitë e sektorit të ujit të miratuara nga Qeveria e Kosovës, përkrahur edhe nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, konsiderojmë se integrimi i të gjitha sistemeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në kuadër të menaxhimit nga KRU-të përkatëse është i një rëndësie të veçantë i cili duhet trajtuar me prioritet dhe seriozitet nga të gjitha palët e interesit.

1.2 NIVELI I SHËRBIMEVE TË UJIT

Gjatë vitit 2025 në përgjithësi shërbimet e furnizimit me ujë nga KRU-të ka qenë në nivel të kënaqshëm, bazuar në raportet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKSHPK), si institucion përgjegjës për monitorimin e kualitetit të ujit. Për vitin 2025, ARRU ka pranuar raportet e kualitetit të ujit për 7 (shtatë) KRU-të, sipas së cilave është arritur përputhshmëria prej 98.8% për testet bakteriologjike dhe 98.9% për testet fiziko-kimike, të cilat janë në nivel të afërsisht të njejtë me vitin 2024.

Pjesa më e madhe e konsumatorëve apo rreth 90.5% e tyre, sipas raportimit të ofruesve të shërbimeve, kanë pasur furnizim të rregullt (pa ndërprerje), ndërsa 9.5% të konsumatorëve kanë raportuar të jenë përballur me furnizim të kufizuar 7.0% me furnizim 18-24 orë dhe 2.5% me furnizim më pak se 18 orë). Vlen të theksohet se ky tregues është më i ulët se në vitin 2024 (ku 97% e konsumatorëve raportuan furnizim të rregullt), ndërsa rritja e numrit të konsumatorëve me furnizim 18-24 orë është e ndikuar kryesisht nga KRU "Bifurkacioni", i cili për vitin 2025 raporton 29,000 konsumatorë me furnizim 18-24 orë, ndërsa në vitin 2024 kishte raportuar vetëm 732 konsumatorë me këtë nivel të vazhdimësisë së shërbimeve.

Në kuadër të zonave me furnizim të rregullt, rreth 1.2% e konsumatorëve, përkatësisht 6,341 konsumatorë, sipas raportimit të KRU-ve, janë përballur me presion të ulët të ujit, krahasuar me 5,013 konsumatorë në vitin 2024.

Furnizimi jo i rregullt me ujë është si pasojë e humbjeve të larta të ujit në rrjet, situatës së pa favorshme në burime të ujit (kapacitete të pa mjaftueshme dhe të ndikuara nga thatësirat) dhe kërkesës së rritur për ujë gjatë sezonës së verës. Zonat e ndikuara nga presioni i ulët janë pasojë e infrastrukturës jo-adekuate, zgjerimi i shpejtë i zonave urbane, pamundësia e KRU-ve për të investuar dhe ndjekur ritmin e zgjerimit të zonave urbane, që reflektohet shtypje të pamjaftueshme tek konsumatorët që jetojnë në zonat e larta.

Menaxhimi i grumbullimit të ujërave të ndotura vazhdon të mbetet sfidë e sektorit të shërbimeve të ujit. Rezultatet nga inspektimi tregojnë se shumica e KRU nuk kanë hartuar ndonjë plan të mirëfilltë të mirëmbajtjes preventive të sistemit të kanalizimit dhe vetëm disa prej tyre kanë ofruar fakte për pastrimin e rregullt të sistemit të kanalizimit (përfshirë edhe pusetat). Të shtatë ofruesit kanë raportuar se gjatë vitit 2025 janë pastruar 612.69 km kanalizim, që përbënë 18.6 % të gjatësisë së vlerësuar të kanalizimit. Nga ana tjetër KRU përballen edhe me vetëdijësimin e ulët të qytetarëve, hudhja e mbeturinave në pusetat e kanalizimit, çështja e ndarjes së përgjegjësive me komunat për bashkë-financim të mirëmbajtjes së sistemeve të ujërave atmosferik, e në pjesën dërmuese këto janë sisteme të kombinuara (kanalizimi i ujërave e ndotur dhe ujërave atmosferik).

Viteve të fundit, të gjitha nivelet e qeverisjes (lokale dhe qendrore), mbështetur edhe nga komuniteti i donatorëve, janë duke i kushtuar një vëmendje të madhe trajtimit të ujërave të ndotura. Deri më tani, në mbarë Kosovën, janë në funksion 7 impiante të trajtimit të ujërave të ndotura, të cilat janë nën menaxhimin e KRU-ve. Këto sisteme së bashku trajtojnë ujërat e ndotura të shkarkuara nga 7% e popullatës.

2. ORGANIZIMI, LICENCIMI DHE MONITORIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

2.1 ORGANIZIMI DHE LICENCIMI I OFRUESVE TË SHËRBIMEVE

Shërbimet e ujit, që përfshinë: furnizimin me ujë të pijshëm, shërbimet e grumbullimit dhe përpunimit të ujërave të ndotur ofrohen nga 7 (shtatë) kompanitë rajonale të ujit të licencuara, siç janë përmbledhur në tabelën 1. Shërbimet e ujit me shumicë të përpunuar ofrohen nga KRU Gjakova për komunën e Mamushës dhe një grup fshatrash të komunës së Prizrenit. Shërbimet e ujit me shumicë të papërpunuar ofrohen nga NH Ibër Lepenci për KRU Prishtina dhe për KRU Mitrovica.

Nga të gjitha këto lloj entitetesh, vetëm shtatë KRU-të dhe NHE Ibër Lepenci janë të licencuara nga Autoriteti për ofrimin e shërbimeve përkatëse, ndërsa të tjerat veprojnë pa licencë. Në Shtator 2018, ARRU ka përtritur Licencat për shërbime për 8 vite për periudhën Shtator 2018 – Shtator 2026.

Zonat (komunat) e mbuluara me shërbime nga 7 Ofruesit e licencuar janë paraqitur në vijim:

Tabela 1. Komunat e mbuluara me shërbime nga 7 Ofruesit e licencuar, në 2025

Emërtimi i ofruesve të shërbimeve të ujit	Komunat e mbuluara me shërbime
KRU Prishtina	Ofron shërbimet e ujit për komunat: Prishtinë; Podujevë; Fushë Kosovë; Obiliq; Lipjan; Shtime; Gllogoc; Graçanicë dhe dy vendbanime të komunës së Vushtrrisë (Prelluzhë dhe Stanoc i Poshtëm).
KRU Hidroregjioni Jugor	Ofron shërbimet e ujit për komunat: Prizren (pa 10 fshatrat të cilat furnizohen nga KRU Gjakova: lista e fshatrave); Suharekë; Malishevë; Dragash; Mamushë[1] Gjatë vitit 2020 për shkak të pamundësisë se ofrimit të shërbimeve të ujit në komunën e Mamushës, ARRU ka tërhequr përkohesisht licenca e shërbimit, deri në rivendosjen e shërbimeve. Në vitin 2025, Ministria e Ekonomisë dhe KRU Gjakova, kanë filluar realizimin e projektit për lidhje edhe të komunës së Mamushës me sistemin e furnizimit me ujë të KRU Gjakova
KRU Hidrodrini	Ofron shërbimet e ujit për komunat: Pejë; Istog; Klinë; Junik; Deçan
KRU Gjakova	Gjakovë; Rahovec; 10 fshatrat e komunës së Prizrenit (Dedaj, Karashëngjergj, Krajk, Krushë e Vogël, Lubizhdë e Hasit, Lukinaj, Piranë, Randobravë, Romajë, Zym). KRU Gjakova është licencuar për të furnizuar ujë të përpunuar me shumicë për 10 fshatrat e komunës së Prizrenit dhe komunën e Mamushës
KRU Mitrovica	Mitrovica Jugore; Vushtrri; Skenderaj; Mitrovica e Veriut; Zveçan; Leposaviç; Zubin Potok

[1] KRU Hidroregjioni Jugor, për shkaqe teknike, nuk ka arritur të furnizojë me ujë banorët e kësaj Komune

Emërtimi i ofruesve të shërbimeve të ujit	Komunat e mbuluara me shërbime
	Nga tetori 2025 KRU Mitrovica është licencuar për të menaxhuar edhe sistemet e 4 (katër) komunave në veri të Kosovës menaxhimin e
KRU Hidromorava	Gjilan; Kamenicë; Viti
KRU Bifurkacioni	Ferizaj; Kaçanik

Sa i përket statusit juridik, të gjithë ofruesit e licencuar janë të regjistruar si ndërmarrje me pronësi publike, si "ndërmarrje publike qendrore". Që të gjitha këto shtatë ndërmarrje publike janë të organizuara si "shoqëri aksionare" në përputhje me ligjin në fuqi për shoqëritë tregtare në Kosovë.

Gjithashtu ekzistojnë edhe disa entitetet në nivel të vend-banimeve rurale, të cilat zakonisht menaxhohen nga një përfaqësues i fshatit ose ndonjë operator privat, që i është besuar detyra e trajtimit të ujit, mirëmbajtjes së rrjetit të ujësjellësit dhe/ose kanalizimit dhe faturimit. Këto entitete veprojnë pa licencë për shërbime, kryesisht pa kontroll të cilësisë së ujit nga IKSHPK dhe nuk posedojnë leje ujore për shfrytëzim të burimeve ujore dhe shkarkim të ujërave të ndotura.

Në këtë kontekst, Autoriteti mirëpret mbështetjen nga institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës (qendrore dhe lokale) për konsolidimin dhe integrimin e këtyre sistemeve nën "ombrellën" e ofruesve rajonal. Për të inkurajuar zgjidhjen e këtij problemi.

2.2 MONITORIMI I OFRUESVE TË LICENCUAR

Kompetencat dhe obligimet e Autoritetit për licencimin dhe monitorimin e kushteve të licencës të ofruesve të licencuar të shërbimeve janë të përkufizuara në Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

Për të përmbushur misionin e lartë përmendur, Njësia për Inspektim në kuadër të Autoritetit, bazuar në mandatin e saj, gjatë vitit 2025 ka zhvilluar inspektime për monitorimin e përmbushjes së nivelit të standardeve të shërbimeve të cilat njëkohësisht janë pjesë e kushteve të licencës. Grumbullimi dhe verifikimi i të dhënave është bërë në bashkëpunim me KRU-të përmes raportimit dhe verifikimit në terren të dhënave dhe nivelit të shërbimeve.

Gjatë nxjerrjes së konkluzioneve për performimin e KRU-ve, bazuar në të gjeturat nga inspektimi të cilat janë përpunuar dhe janë prezantuar në kapitujt në vijim të këtij Raporti, është marrë parasysh edhe ndikimi i faktorëve të jashtëm në strukturën, qëndrueshmërinë dhe koston e shërbimeve. Në përgjithësi, kushtet specifike rajonale përcaktojnë edhe strukturën e furnizimit me ujë si dhe grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura. Furnizimi me ujë edhe gjatë këtij viti, në një pjesë të madhe të zonës së shërbimit të KRU-ve, është ndikuar nga kushtet klimatike, e sidomos në regjionet të cilat bazohen nga burime sipërfaqësore apo nëntokësore.

3. NIVELI I SHËRBIMEVE I SIGURUAR NGA OFRUESIT E LICENCUAR TË SHËRBIMEVE TË UJIT

Në këtë Kapitull është paraqitur niveli i shërbimeve të ofruara nga shtatë KRU-të për shërbimet e ujësjellësit, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, gjatë vitit 2025 si dhe paraqitja e trendeve zhvillimore krahasuar me vitin 2024.

Për vitin 2025, monitorimi dhe vlerësimi i nivelit të shërbimeve është bazuar në të dhënat e inspektuara në zyret e KRU dhe nga vizitat në teren. Si çdo vit, të dhënat dhe informacionet e inspektuara, për secilën KRU, janë ruajtur në Module të veçanta ku edhe janë përpunuar në tregues konkret. Këto Module i shërbejnë Autoritetit si një vegël për monitorimin e nivelit të shërbimeve të ofruara nga KRU kundrejt standardeve dhe rregullave të përcaktuara nga Autoriteti, si dhe për të monitoruar dhe krahasuar trendin e standardeve të shërbimit për secilën KRU veçmas.

Gjatë inspektimit është verifikuar edhe burimi i të gjitha të dhënave me qëllim që të vlerësohet shkalla e besueshmërisë së tyre - janë përdorur tre shkallë të besueshmërisë: e besueshme; mesatarisht e besueshme; dhe e pa-besueshme.

Sa i përket sistemeve të regjistrimit, ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave, në përgjithësi, mund të konkludohet se ato nuk janë ende në nivelin e kënaqshëm të zhvillimit dhe përdorimit të tyre, prandaj të dhënat e grumbulluara, të cilat burojnë nga këto sisteme, konsiderohen pjesërisht të besueshme. Informacione më të hollësishme në lidhje me besueshmërinë e secilit grup të të dhënave janë paraqitur në Kapitullin 5 të këtij Raporti.

3.1 QASJA E POPULLATËS NË SHËRBIMET E UJËSJELLËSIT

Ofruesit e licencuar të shërbimeve (KRU-të) të ujësjellësit, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura sigurojnë shërbime të ujësjellësit tek 83% e popullatës (ndërsa në vitin 2024 ishte 82%). Ky tregues paraqet përqindjen e popullatës që furnizohen nga sistemet e menaxhuara nga KRU në raport me popullatën e përgjithshme brenda zonës së licencuar të shërbimit.

Shprehur në terma të vend-banimeve, nga gjithsej 1,297 janë vetëm 691 vend-banime që kanë qasje në sistemet publike të ujësjellësit të menaxhuara nga KRU.

Integrimi i sistemeve rurale te furnizimit me ujë të cilat janë ndërtuara mirëpo janë jashtë menaxhimit nga KRU-ve edhe gjatë vitit 2025 ka vazhduar të jetë tejet i ngadalshëm.

Janë edhe një numër i konsiderueshëm i sistemeve rurale të rehabilituara, ku ekzistojnë lidhjet individuale, mirëpo popullata nuk është e pajtimit që sistemi i tyre të menaxhohet nga KRU duke preferuar kështu menaxhimin individual (të pa-ligjshëm) të këtyre sisteme. Në këto raste rekomandohet iniciativë dhe angazhim më i madh institucional në vetëdijësimin e këtyre banorëve për pasojat e konsumit të ujit të pa-përpunuar dhe pa-kontrolluar dhe degradimit të aseteve në rast të mungesës së mirëmbajtjes së rregullt të tyre.

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit në format të hartave është siguruar në Shtojcën 1 të këtij Raporti.



Grafiku 1: Mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit, 2024-2025

Tabela 2. Të dhënat kryesore të nivelit të shërbimeve, 2024-2025

Treguesi i nivelit të shërbimit	Njesia	2024	2025	Ndryshimi
Mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit	%	82.26%	82.60%	+0.33
Mbulueshmëria me shërbimet e grumbullimit të UN	%	69.58%	69.86%	+0.28
Mbulueshmëria me shërbimet e trajtimit të UN	%	11.08%	7.00%	-4.09
Numri i popullatës në zonën e shërbimit	nr.	1,578,591	1,575,627	-2,964
Popullata me qasje në sistemin e ujësjellësit	nr.	1,298,598	1,301,397	2,799
Konsumatorët që furnizohen me ujë	nr.	482,004 (përfshirë kultet fetare)	510,530 (përfshirë kultet fetare)	28,586
Konsumatorët që furnizohen 24 orë me ujë	nr.	469,788	462,001	-7,787
Uji i prodhuar dhe i trajtuar	m^3	205,881,519	202,191,673	-3,689,846

Uji i konsumuar dhe i shitur	m³	68,581,910 (pa përfshirë Komunat e Veriut)	70,167,504 (pa përfshirë Komunat e Veriut)	1,585,594
Gjatësia e rrjetit të ujësjellësit	km	9,490.9	9,425.0	-65.9
Gjatësia e rrjetit të kanalizimit	km	3,368.1	3,300.6	-67.5
Plasaritjet në rrjetin e ujësjellësit	nr./km	1.73	1.76	0.04
Vërshimet/ defektit në rrjetin e kanalizimit	nr./km	3.75	3.83	0.08
Faturimi sipas standardeve të faturimit	%	99.51%	99.73%	+0.21
Ankesat teknike të shqyrtuara brenda kohës standarde	%	100.00%	99.64%	-0.36

Autoriteti apelon menaxhementin e të gjitha KRU që të zbatojnë kërkesat ligjore dhe standardet teknike për ekzekutimin e lidhjeve të reja dhe legalizimin e atyre ekzistuese të konsumatorëve, ashtu që të shmangen pasojat nga lidhjet e ekzekutuara jashtë standardeve, e që kanë ndikim të drejtëpërdrejt në rritjen e humbjeve fizike (teknike) dhe komerciale të ujit. Poashtu rekomandohet Menaxhmenti që të angazhojë stafin e tyre në inspektimin rutinor gjatë ekzekutimit të lidhjeve ekzistuese dhe marrjen e masave përkatëse ndaj lidhjeve që nuk plotësojnë standardet teknike.

3.2 FURNIZIMI I KONSUMATORËVE ME UJË

3.2.1 Burimet e ujit dhe kërkesa për ujë

Kërkesa për qasje në ujësjellës do të vazhdojë të jetë në rritje deri në mbulimin e popullatës me këtë shërbim. Autoriteti aprovon investime në sisteme ujëfurnizuese, që të garantojë një furnizim të besueshëm dhe të mirëmbajë nivel të kënaqshëm të nivelit të shërbimeve. Nga ana tjetër, është vërejtur se ekziston një bashkëpunim jo aq efektiv në mes të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore - ARPL (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - MMPHI) dhe KRU në fushën e obligimeve të ndërsjella, sidomos tek lejet ujore për burimet e ujit që janë në shfrytëzim.

3.2.2 Prodhimi i i ujit

Gjatë vitit 2025, sasia e ujit të prodhuar dhe të trajtuar ka qenë 202,191,673 m³, që krahasuar me vitin 2024 është për 1,659,320 m³ më shumë (rritje prej 0.83%).

Siç mund të vërehet të gjitha KRU-të kanë pasur ndryshime prodhimi i ujit, për arsye të zgjerimit të zonës së shërbimit apo ritjes së kërkesës së konsumit, mirëpo rritja më e madhe vërehet tek KRU Hidroregjioni Jugor (+4,001,722 m³), rënie vërehet tek KRU Mitrovica (-1,077,675 m³) dhe KRU Hidrodrini (-1,681,854 m³).

Gjatë vitit 2025, të dhënat lidhur me prodhimin e ujit janë raportuar në Sistemin Informativ për Shërbimet e Ujit (SISHU) nga KRU për secilën pikë të prodhimit dhe në baza mujore.

Tabela 3. Uji i prodhuar dhe i trajtuar sipas KRU, 2024-2025

Emërtimi i Ofruesve të shërbimeve të ujit	Uji i prodhuar dhe i trajtuar (m^3/vit)		Raporti 2025-2024
	2024	2025	%
KRU Prishtina	59,390,305	59,531,854	+0.24%
KRU Hidroregjioni Jugor	31,127,858	35,129,580	+12.86%
KRU Hidrodrini	48,238,121	46,556,267	-3.49%
KRU Gjakova	16,202,875	16,215,043	+0.08%
KRU Mitrovica	28,007,939	26,930,264	-19.27%
KRU Hidromorava	9,087,374	9,270,357	+2.01%
KRU Bifurkacioni	8,477,881	8,558,308	+0.95%
SEKTORI	200,532,353	202,191,673	+0.83%

3.2.3 Vazhdimësia e furnizimit me ujë të pijshëm

KRU-të janë të obliguara të ofrojnë ujë të pijshëm me sasi të mjaftueshme, pa ndërprerje, në kushte të njëjta, për të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Gjatë vitit 2025 shumica e KRU-ve kanë arritur në përgjithësi t'a përmbushin këtë standard, megjithatë të dhënat e raportuara dëshmojnë një rënie të shkallës së furnizimit të rregullt (nga 97.5% në vitin 2024 në 90.5% në vitin 2025).

Sipas të gjeturave nga inspektimi, të gjitha KRU-të që kanë aplikuar reduktime të planifikuara të furnizimit me ujë kanë bërë publikimin e orarit të reduktimeve si dhe i kanë mbajtur konsumatorët të njoftuar për të gjitha masat e marrura për tejkalim të gjendjes.



Grafiku 2: Sigurimi i vazhdueshmëm i konsumatorëve me ujë, 2025

Përveç reduktimeve të planifikuara, edhe gjatë vitit 2025, një numër i konsumatorëve vazhdojnë të përballen me problemin e vazhdimësisë me ujë për shkak të presionit të ulët, sidomos gjatë sezonës së verës. Nga të dhënat e raportuara nga KRU-të, numri i konsumatorëve që janë përballur me këtë problem është rritur nga 5,013 sa ishte në vitin 2024 në 6,341 në vitin 2025, ku kontributi më i madh vjen nga KRU Prishtina (3,140 konsumatorë), KRU Bifurkacioni (2,000 konsumatorë) dhe KRU Hidroregjioni Jugor (826 konsumatorë).

Sipas të dhënave të vlerësuara dhe të raportuara nga KRU, presioni mesatar i ujit për të gjitha KRU është rreth 3.74 bar (në kushtet e normale të përdorimit të ujit, presioni hidraulik në gypin e lidhjes së konsumatorit duhet të jetë jo më pak se 1.5 bar dhe jo më shumë se 7 bar). Autoriteti nuk ka mundësi të verifikimit të këtij standardi në terren, pasi KRU-të nuk kanë pajisje për matjen e presionit të instaluara në rrjetin shpërndarës.

Duhet sqaruar se në rastet kur presioni është më i ulët se 1.5 bar është përgjegjësi e KRU që të vendos pajisje për rregullimin e presionit në mënyrë të përmbushet ky standard. Ndërsa, sa i përket ndërtesave shumëkatëshe, është përgjegjësi e investitorëve që të sigurojë presion adekuat deri në pikat/ katet e larta.



Grafiku 3: Presioni mesatar zonal, 2004-2025

3.2.4 Ndërprerja e furnizimit me ujë për shkak të punimeve

Gjendja e përgjithshme e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe mirëmbajtja preventive e tyre janë dy faktorë që ndikojnë në qëndrueshmërinë e funksionimit të rrjetit shpërndarës.

Të gjeturat nga inspektimi tregojnë se KRU vazhdojnë të kenë probleme me defektet në gypa të ujit, të cilat sipas të dhënave të raportuara zakonisht sanohen brenda kohës standarde. Mirëpo, duke pasur parasysh se sistemet e ruajtjes dhe përpunimit të këtyre të dhënave nuk janë mjaftueshëm të besueshme.

Sa i përket njoftimit të konsumatorëve në rastet e ndërprerjeve të planifikuara por edhe për ato të pa-parapara të furnizimit me ujë, duke shfrytëzuar mediat elektronike (web faqet, rrjetet sociale dhe njoftimet ne media) vlerësohet se KRU kanë respektuar standardin.

3.3 CILËSIA E UJIT TË FURNIZUAR

Monitorimi i cilësisë së ujit është i rregulluar përmes Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 10/2021 për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor, sipas të cilit UA, KRU-të janë përgjegjëse për monitorim operacional, ndërsa IKSHPK për monitorimin e përputhshmërisë së cilësisë së ujit me standardet e përcaktuara.

Testet e realizuara nga këto KRU kryesisht shfrytëzohen për monitorimin e parametrave të cilësisë së ujit përgjatë procesit të trajtimit duke filluar që nga testimi i ujit të pa-trajtuar në burim.

Autoriteti ka pranuar raporte të cilësisë së ujit nga IKSHPK për vitin 2025 për shtatë KRU. Sipas këtyre të dhënave për zonat e furnizuara nga 7 KRU, përputhshmëria ka qenë 98.8% për testet bakteriologjike dhe 98.9% për testet fiziko-kimike.



Grafiku 4: Testet në përputhshmëri me standardet bakteriologjike të ujit, 2024-2025



Grafiku 5: Testet në perputhshmëri me standardet fiziko kimike të ujit, 2024-2025

3.4 GRUMBULLIMI DHE TRAJTIMI I UJËRAVE TË NDOTURA

Përveç shërbimit të furnizimit me ujë, KRU-të sigurojnë edhe shërbimin e grumbullimit të ujërave të ndotura. Në vitin 2025, ky shërbim është ofruar për rreth 69.86% të popullatës, ndërsa në vitin 2024 ishte 69.58%. Ky ndryshim në përqindjen e mbulueshmërisë së me ujërat e ndotura është kryesisht si rezultat zvogëlimit të numrit të popullatës sipas regjistrimit të fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe disa korigjimeve të dhënave lidhur me numrin e banorëve tek KRU Hidroregjioni.

Mulushmëria me shërbimet e përpunimit të ujërave të ndotur është ende e ulët; në vitin 2025 ujërat e ndotur të shkarkuar vetëm të 7% të popullatës së Kosovës, përfundojnë në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura. Ky tregues në vitin 2024 ka qenë 11%, pra ka një ulje, që është kryesisht rezultat i publikimit të dhënave të sakta të regjistrimit të popullsisë nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK).

Nga volumi i përgjithshëm e ujërave të ndotur të faturuar nga KRU-të, vetëm 22% (shprehur ne m^3) trajtohet në impiantet e përpunimit të ujërave të ndotur, e njëjta % ka qenë edhe në vitin 2024.

Nga inspektimet në KRU, është vërejtur dukuria e menaxhimit të një numri të sistemeve të kanalizimit, të cilat pranojnë shërbimet e mirëmbajtjes por nuk faturohen fare. Me qëllim të eliminimit të kësaj dukurie, Autoriteti vazhdon të rekomandojë KRU-të dhe institucionet tjera përgjegjëse (komunat) që të arrijnë marrëveshjet përkatëse për marrjen në menaxhim të këtyre sistemeve.

Ujërat e ndotura të grumbulluara, në mungesë të impianteve të përpunimit të ujërave të ndotur, vazhdojnë të shkarkohen në rreth 30 trupa ujore (lumenjë dhe përrocka) duke krijuar probleme enorme në mjediset akuatike.

Sipas të dhënave të raportuara, në të gjitha impiantet trajtimit të ujërave të ndotur, testet kimiko-fizike dhe biologjike tregojnë se uji i trajtuar është në përputhshmëri me standardet e nevojës biokimike për oksigjen (eng.: BOD_5) në masën 99% ndërsa në vitin 2024 ishte 100%.

Detajet e mbulueshmërisë me shërbimet e grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura mund të lexohen në diagramet në vijim.



Grafiku 6: Mbulueshmëria me shërbimet e ujërave të ndotura

3.5 FATURIMI PËR SHËRBIMET E OFRUARA

Gjatë inspektimit të zhvilluar për vitin 2025 është konfirmuar se faturimi në përgjithësi është kryer sipas standardeve, ndërsa është vërejtur një rritje e numrit të konsumatorëve nga 481,450 në vitin 2024, në 510,017 në vitin 2025.



Grafiku 7: Konsumatorët e faturuar sipas standardeve të faturimit

Ndërsa trendi prej vitit në vit i përmirësimit të matjes së ujit të konsumuar, për secilën KRU, është paraqitur në diagramin në vijim.



Grafiku 8: Uji i faturuar dhe matur

Rezultatet nga të dhënat e gjetura tregojnë se për vitin 2025, nga të gjitha KRU janë instaluar gjithsej 28,885 ujëmatës përfshirë ato në lidhjet e reja si dhe zëvendësimin e ujëmatësve ekzistues, ndërsa në vitin 2024 ishin instaluar 21,599 ujëmatës.

Zëvendësimi i ujëmatësve të vjetër dhe testimi/ kalibrimi i rregullt i tyre mbesin ende një sfidë për të gjitha KRU. Edhe gjatë vitit 2025 KRU nuk kanë pasur Plan të menaxhimit të ujëmatësve, sipas së

cilit do të planifikohej me kohë zëvendësimi i ujëmatësve. Përkundër kësaj, zëvendësimi i ujëmatëve bëhet bazuar në kërkesat e aty për atyshme të konsumatorëve.

ARRU rekomandon që KRU-të të hartojnë Planin për menaxhmin e ujëmatësve, të zëvendësojnë ujëmatësit e vjetër në kohë, nga përvoja ujëmatësit e vjetër regjistrojnë zakonisht më pak, e kjo reflektohet edhe në humbje të ujit.

3.6 RELACIONI "KRU-KONSUMATORË"

Një prej përgjegjësive kryesore të Autoritetit është mbrojtja e të drejtës së konsumatorëve, përmes shqyrtimit të ankesave në shkallpn e dytë të procedurës adminstrative.

Nga të gjeturat mund të konkludohet se të gjitha KRU kanë në funksion: (i) zyrën e veçantë që shfrytëzohet për pranimin e ankesave/reagimeve nga konsumatorët - në zyret qendrore si dhe hapësira në zyret e njësive operative; (ii) shfrytëzojnë aplikacionet eletronike për regjistrimin dhe përpunimin e të dhënave (kryesisht vetëm ne zyret qendrore); dhe (iii) komisionet për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve (KZAK) – shkalla e parë (që funksionon në kuadër të KRU-së). Ndaj çdo vendimi të KZAK - shkalla e parë, nëse konsumatori vlerëson se i janë shkelur të drejtat, i drejtohet me ankesë komsionit të shkallës së dytë (që funksionon në ARRU).

Duhet theksuar se të dhënat të cilat merren nga ankesat e konsumatorëve, vazhdojnë të mos shfrytëzohen dhe të analizohen nga Menaxhmentet e KRU-ve gjatë marrjes së vendimeve për përmirësimin e nivelit të shërbimeve. Kjo po bën që numri i ankesave në ARRU të rritet nga viti në vit.

Në vazhdimësi ARRU ka kërkuar nga KRU-të të bëhet identifikimi dhe ndarja e saktë e ankesave, lajmërimeve, kërkesave etj, kriter ky i cili tanimë është plotësuar nga KRU "Bifurkacioni", "Hidroregjioni Jugor", "Hidromorava" dhe "Prishtina" të cilat i kanë të sistemuara mirë ankesa/ lajmërimet.

KRU-të tjera kanë pasur shumë pak progres, prandaj edhe identifikimi i saktë i numrit të ankesave, sidomos ato teknike, është i veshtirë gjë që ndikon në besueshmërinë e kesaj të dhëne.

Detajet e ankesave, sipas tematikës mund të lexohen në diagramet në vijim.



Grafiku 9: Ankesat teknike (për ujësjellës), 2025



Grafiku 10: Ankesat komerciale (për ujësjellës dhe ujërat e ndotura), 2025

Sipas standardit të përcaktuar nga Autoriteti kërkohet që të gjitha ankesat dhe kërkesat të shqyrtohen brenda një periudhe të caktuar kohore. Të gjeturat nga inspektimi tregojnë se nga mënyra e organizimit të tanishëm të modulit përkatës nuk është e lehtë të gjurmohet me saktësi koha e shqyrtimit të ankesave/kërkesave. Gjatë inspektimit është sverifikuar se brenda vitit janë shqyrtuar 99.6% e ankesave teknike të deponuara për shërbimet e ujësjellësit, 100% e ankesave teknike për shërbimet e ujërave të ndotura dhe 99.8% e ankesave komerciale për të dy shërbimet.

Një relacion tjetër në mes të konsumatorit dhe KRU është edhe komunikimi përmes mediave të ndryshme përfshirë edhe rrjetet sociale. Në këtë aspekt mund të thuhet se të gjitha KRU vazhdojnë të kenë komunikim ditor me konsumatorët e tyre. Komunikimi kryesisht është i karakterit informativ për problemet që ndodhin në teren. Mirëpo, përkundër që konsumatorët informohen për problemet e

ndodhura ata nuk janë shumë në dijeni për të drejtat dhe obligimet e ndërsjellta me KRU pasi që shumica e tyre nuk janë në dijeni të ekzistimit të kartës së konsumatorit dhe kontratës për shërbime. Prandaj, Autoriteti rekomandon që të gjitha KRU-të që në të gjitha zyret e relacionit me konsumatorë karta e konsumatorit të jetë në vend të dukshëm dhe lehtë e qasshme për konsumatorët dhe të rrisë aktivitetet sa i përket nënshkrimit të kontratave.

3.6.2 Kënaqshmëria e konsumatorëve

Të dhënat lidhur me kënaqshmërinë e konsumatorëve për shërbimet e marra të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura për vitin 2025 janë marrë nga Raportet e Hulumtimit për Opinionin e kënaqshmërisë së konsumatorve të zhvilluara nga KRU-të.

Nga të gjeturat e Raporteve të Hulumtimit për Opinionin e kënaqshmërisë së konsumatorëve të zhvilluara nga KRU-të vërehet se në përgjithsi kënaqshmëria e konsumatorëve për shërbimet e ofruara është e lartë. Në shumicën e rasteve, opinionet e konsumatorëve japin një pasqyrë ndryshe të nivelit të shërbimeve nga ajo e siguruar nga KRU. Kjo diskrepancë do të hulumtohet më tutje nga Autoriteti.

Në grafikonin e më poshtëm shihen treguesit e kënaqshmërisë së konsumatorëve për shtatë KRU.



Grafiku 11: Kënaqshmëria e konsumatorëve me shërbimet e KRU (për ujësjellës dhe ujëra të ndotur, 2025

4. QËNDRUESHMËRIA E SHËRBIMEVE

Është mandat i Autoritetit, që përmes mekanizmave në dispozicion, të sigurojë qëndrueshmëri të shërbimeve të ujit të ofruara nga ofruesit e licencuar.

Kjo nënkupton siguri afatgjatë e furnizimit me ujë të pijshëm me cilësi të sigurtë dhe sasi të mjaftueshme, grumbullim dhe trajtim adekuat të ujërave të ndotura, plotësim standardeve të shërbimit dhe menaxhim të kujdesshëm të burimeve ujore dhe ndaj infrastrukturës tjetë që e menaxhon.

Për të mbajtur qëndrueshmërinë afatgjate të shërbimeve, për periudhën valide të Licencës, KRU duhet të përkujdesen që të:

(i) kenë në dispozicion burime të mjaftueshme të ujit, që përmbushë kërkesat në rritje të konsumatorëve për ujë.

Në bazë të dhënave në dispozicion mund të vlerësohet se edhe për vitin 2025, secila KRU ka mbuluar kërkesat për ujë të konsumatorëve. Duke marrë parasysh se një sasi e madhe e ujit shfrytëzohet nga lidhjet e pa-autorizuara dhe po ashtu humbet nga rrjedhjet e gypave, në disa KRU është paraqitur problemi i pa-mjaftueshmërisë së ujit nga disa burime që kanë në shfrytëzim. Prandaj rekomandohet që KRU urgjent të ndërmarrin masat e duhura për një menaxhim më të mirë të kërkesës, konsumit dhe disponueshmërisë me ujë për secilën zonë dhe burim veçmas. Në kuadër të këtij menaxhimi do të duhej një bashkëpunim shumë më i madh me MMPHI.

